



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 5.5.2015, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku-nënkryetar i parë, Ganimete Musliu, Anton Quni, Rexhep Selimi, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Mungoi: Bojan Mitiq.

Përfaqësuesit nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian(OSBE)- Jean- Claude Schlumberger, ambasador i Misionit të OSBE në Kosovë; Christopher Tuetsch, drejtor i Departamentit për Demokratizim dhe Senad Saboviq, shef i Njësisë për Politika dhe Komunikim.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hajdari, EULEX; Luanda Domi, DACF dhe Arbanë Pireva, praktikante.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

Takim me ambasadorin e Misionit të OSBE në Kosovë, shkëlqesinë e tij, z. Jean-Claude Schlumberger.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryetari- Fillimisht, prezantoi përbërjen e Komisionit dhe falënderoi misionin e OSBE-së për kontributin e dhënë në fushën e demokratizimit dhe mbështetjes së shumë proceseve. Ndërsa, fushëveprimtaria e Komisionit që e drejtoj mbulon fusha më specifike dhe fokusimi është në fushën e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, hartimin e ligjeve. Bashkëpunimi në Komision është i mirë dhe gjatë kësaj kohe janë krijuar grupe punuese, vizita në terren, raportime të ministrive dhe departamenteve përkatëse dhe ekziston vullneti për të punuar.

Falënderoi për përkrahjen dhe mundësinë për të bashkëpunuar, më tutje fjalën ia dha ambasadorit, z. Schlumberger.

Jean- Claude Schlumberger, Ambasadorin e Misionit të OSBE në Kosovë- Shprehu nderin për takimin me anëtarët e Komisionit dhe theksoi që misioni i OSBE-së, në bazë të mandatit që ka, ka mbështetur Kuvendin e Kosovës, veçanërisht përmes komisioneve parlamentare. Tutje theksoi se ka vlerësuar si një mundësi të mirë për t'u takuar me Komisionin, pasi tashmë është legjislatura e re. Gjithashtu, theksoi se janë më tepër se dhjetë vite të bashkëpunimit të përbashkët dhe do të vazhdojmë këtë bashkëpunim, në mënyrë të mirë.

Siç mund të jeni në dijeni, kemi filluar planin për këtë vit, ku janë paraparë një numër i aktiviteteve për këtë vit. Theksoi aktivitetin e fundit, i cili është realizuar më 21 prill, tryezë e rrumbullakët për mbikëqyrjen e Ligjit për Policinë, ku OSBE ka mbështetur. Po ashtu, konsiderojmë bashkërisht se çështja e mbikëqyrjes dhe zbatimit të ligjeve, është shumë e rëndësishme. Gjithashtu, gjatë muajit prill, OSBE-ja ka organizuar një vizitë studimore në Ljublanë, ku z.Daut Haradinaj ka qenë pjesë e delegacionit, në cilësinë kryetarit të Komisionit. Qëllimi i kësaj vizite ishte për të parë modelin sloven gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjit të Kosovës për qasje në dokumente publike dhe në mbrojtjen e të dhënave personale.

Po ashtu, sapo ka përfunduar një aktivitet i cili është realizuar më 27-29 prill, në Forumin Parlamentar të Cetinës në Mal të Zi, ku morën pjesë disa nga anëtarët e Komisionit. Këta janë disa nga shembujt për të treguar se çfarë lloj mbështetje është e gatshme të japë OSBE, përfshirë edhe dimensionin rajonal, i cili është i rëndësishëm dhe ne do të ndihmojmë të promovojmë këtë dimension. Gjithashtu, do të vazhdojmë mbështetjen në fushën e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve në fushën e sigurisë publike, e cila është shtyllë e qeverisjes demokratike.

Jemi të lumtur në ofrimin e mbështetjes në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Policinë e Kosovës, i cili është në procedurë. Po ashtu, shumë shpejt do të organizojmë disa vizita në terren për Komisionin, në pikën e kalimit kufitar në Merdare dhe në Vermicë. Gjithashtu, do të bashkëpunojmë në fushën e mbikëqyrjes buxhetore për ministrinë e linjës.

Në vijim, përmendi mbështetjen që i ofrohet Zyrës së Kryeministrit dhe Komisionit në përmirësimin dhe implementimin e kornizës ligjore për dokumentet publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, kemi qenë të angazhuar dhe kemi mbikëqyrur dhe adresimin e disa shqetësimeve aktuale të Kosovës dhe më gjerë. Kjo ka të bëjë me përfshirjen e qytetarëve rezidentë të Kosovës në konflikte në Siri dhe Irak. Për këtë arsye, na është kërkuar nga Qeveria për të dhënë mbështetjen tonë për të ndihmuar grupin punues gjatë procesit të hartimit të Strategjisë për parandalimin e radikalizmit, ekstremizmit dhe terrorizmit. Për këtë qëllim, OSBE-ja ka

planifikuar tre punëtori, ku njëra nga këto punëtori është mbajtur javën e kaluar, ku ka rezultuar me disa rekomandime.

Më tutje, tha se do të përmendja edhe një aspekt tjetër, ku monitoruesit tanë kanë vëzhguar Policinë e Kosovës në veri të vendit, ku është vërejtur që ka pasur mosmarrëveshje në furnizimin me logjistikë, si dhe në ndërtimin e infrastrukturës. Kjo, normalisht, ka pasur efekt negativ në kushtet e punës dhe në efektivitetin e punës së tyre.

Gjithashtu, është duke ndodhur një gjë shumë e rëndësishme në veri të vendit, që ka të bëjë me integrimin e policisë dhe çfarëdo që ju si anëtarë të Komisionit mund të bëni për ta shtyrë këtë çështje tutje, është e mirëpritur.

Në takimin paraprak me kryetarin, z. Haradinaj, kemi folur edhe për mbështetjen me ekspertizë për Komisionin nga misioni i OSBE-së dhe mund të ofrohet mbështetje për Komisionin.

Për këtë legjislaturë, iu uroj sukses në punët dhe aktivitetet e planifikuara.

Kryetari- Theksoi se në takimin paraprak që patën me ambasadorin, e ka njoftuar me planin vjetor të punës, si dhe për projektligjet që konsiderohen më të ndjeshme, mbikëqyrjen e Ligjit për Policinë, mbikëqyrjen financiare, si dhe është bërë kërkesë për mbështetje me ekspertë profesionistë që e njohin këtë fushë.

Anton Quni- Theksoi se e çmon me një konsideratë të lartë punën e deritanishme që e ka bërë misioni i OSBE-së në Kosovës, por theksoi se do të fokusohet në një çështje dhe përjetim personal gjatë pjesëmarrjes në Forumin Parlamentar të Cetinës, nga data 27-29 prill, me Temë: “Barazia gjinore në sektorin e sigurisë dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes”.

Pjesëmarrja në këtë forum ishte në interesin tonë, për shkëmbimin e përvojave dhe marrja e njohurive të reja, por me fillimin punimeve të këtij forumi, ne si delegacion nga Kosova u ndeshëm me një klimë jo aq të këndshme, pasi u vërejt që nuk jemi të përfaqësuar në mënyrë të barabartë me shtetet tjera të rajonit. Ne i kuptojmë politikat e OSBE-së ndaj statusit të Kosovës, por sidoqoftë arritëm që me nikoqirët, me një marrëveshje gjentellmëne, ata t’i plotësojnë kushtet, që ne si delegacion të ndienim veten të barabartë.

Pas kësaj, u gjet modaliteti që asnjë përfaqësues i asnjë shteti të mos e ndiej veten inferior në raport me shtetet tjera.

E theksova këtë për të treguar që kur ekziston një vullnet i mirë për një çështje të interesit të përbashkët, mendoj që edhe zyrtarët e OSBE-së mund të tejkalojnë disa formalitete dhe të gjendet zgjidhje që është kompromis i të gjithëve, që për çështje që është shqetësim i përbashkët, të mos të ndihet askush i anashkaluar.

Ndërsa, sa i përket çështjeve të tjera të nivelit të lartë politik, mosmarrëveshjet që mund të ekzistojnë në raport mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, janë takime që organizohen në nivel më të lartë, ku siç e dimë, disa nga marrëveshjet janë miratuar e disa janë në procedim, ndërsa secila palë t’i përmbahet.

Shembulli i përfaqësimit tonë në këtë forum, marrëveshja që kemi bërë me nikoqirët dhe me zyrtarët e OSBE-së, është një shembull i mirë që situata të tilla mund të tejkalohen.

Jean- Claude Schlumberger, ambasador i Misionit të OSBE-së në Kosovë- Theksoi se ajo çfarë tha z. Quni, është e drejtë, por janë disa probleme lidhur me çështjen që ngriti z. Quni për pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Kosova në takime të tilla. Më tutje, theksoi se si misioni i

OSBE-së provojnë që çdo herë të gjejnë zgjidhjen e duhur, e cila është e pranueshme dhe mund të jetë e pranuar nga palët e tjera. Gjithashtu, duhet të dimë që obligimet që kemi si mision dhe që varem nga Vjena dhe nga kryesimi i këtij viti i OSBE-së.

Jam i lumtur që problemi i paraqitur në fillim, është zgjidhur në mënyrë pozitive dhe ju falënderoj ju dhe kolegët e juaj pjesëmarrës në këtë forum. Theksoi se për misionin e OSBE-së, gjithmonë është pak e vështirë për të gjetur zgjidhje paraprakisht. Shpresoj që hap pas hapi do të jemi të gatshëm të propozojmë zgjidhje të pranura për të gjithë.

Rexhep Selimi- Theksoi se ky takim vjen pas një pune të mirë dhe bashkëpunimit të mirë që bëhet mes Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe OSBE-së. Komisioni parlamentar që merret me çështjet e sigurisë, është themeluar në vitin 2006 dhe disa nga anëtarët që tashmë kemi mandatin dytë në këtë Komision, kemi pasur bashkëpunim gjithëpërfshirës dhe të mirë me OSBE-në.

Po ashtu, theksoi se roli i OSBE-së në procesin e hartimit dhe procedimin projektligjeve, ka qenë i rëndësishëm, dhe me të drejtë, presim mbështetjen e juaj edhe në të ardhmen. Përvoja e fundit në pjesëmarrjen në Forumin Parlamentar të Cetinës dhe për këtë falënderoi nikoqirin dhe organizatorin. Rol shumë të mirë gjatë qëndrimit dhe pjesëmarrjes në këtë forum, ka dhënë z.Peter Welling, përfaqësues nga OSBE dhe shoqërues i delegacionit, ku kemi pasur bashkëveprim të mirë dhe për këtë shprehu falënderim.

Prandaj, vlerësoi se kontributi i OSBE-së në mbështetjen e shqyrtimit të ligjeve, tryezave, takimeve është i mirëpritur, pra mbështetja është e mirëpritur.

Fadil Demaku- Theksoi se bashkëpunimi me OSBE-në, siç u theksua edhe këtu, duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen. Gjithashtu u përmendën sfidat që janë në sektorin e sigurisë, dhe sa më i fuqishëm bashkëpunimi mes dy palëve, për ne do të përshpejtohet rruga drejt integriteteve, sidomos në fushën e sigurisë.

Qerim Bajrami- Fillimisht, theksoi se përfaqëson Grupin Parlamentar 6+ dhe si përfaqësues të komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Kosovë, ndihen qytetarë të Kosovës dhe janë të integruar në shoqëri, por nuk janë mjaftueshëm të përfaqësuar në institucione. Më pas, falënderoi për përkrahjen e deritanishme të dhënë nga ana e OSBE-së për Komisionin dhe institucionet e Kosovës. Mendoj që do të vazhdoni të mbështesni në procesin e anëtarësimit dhe integritetit në organizata dhe institucione ndërkombëtare. Në fund, falënderoi znj.Ardiana Gashi, përfaqësuese e OSBE-së, e angazhuar me punë në Kuvend, për koordinimin e mirë të aktiviteteve.

Nuredin Ibishi- Theksoi se duke qenë pjesëmarrës në Forumin e Cetinës, ka qenë një moment shumë domethënës që nganjëherë i zbeh rezultatet, por vlerësoi lartë punën e bërë nga ana e OSBE-së, ndërsa s ai përket aspektit të neutralitetit karshi Kosovës nga ana e OSBE-së, vlerësoi se duhet të gjenden modalitetet dhe kjo të tejkalohet.

Më tutje, shtoi se në kuadër të punës, është kryesues i grupit për mbikëqyrjen e Ligjit për Policinë, ku do të ketë takime me aktorë të tërë që ndërlidhen me punën e policisë, që në përfundim të kësaj mbikëqyrjeje, të bëhen rekomandime.

Kryetari- Shtoi se jo gjithëherë situatat politike na bëjnë të ndihemi mirë, kur bëhet fjalë për përfaqësimin e barabartë në takime rajonale dhe vlerësoi se edhe Serbia, sa më shpejt që të njohë

realitetin, do të jetë më mirë. Në mbyllje të takimit, në emër të anëtarëve të Komisionit, falënderoi për përkrahjen dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj